Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE: T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija: Prishtine
RrugaEmin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 127 | PRISHTINE, e dielle 25 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

Njerëzit punues te Krahines s'onë e pershendesin Kongresin e Peste te PKJ dhe kerkojnë qe t'a zgjedhe perseri Komitetin e deritashem Qendruer me shokun Tito ne krye

Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis

Beograd

Komiteti i vendit te PKS ne Prishtine i dergon pershendetje te nxehta shoqnore Kongresit te Peste te PKJ dhe i dishron sukses te mdhaja ne punen e tij.

Komiteti i vendit te PKS ne Prishtine kerkon unanimisht qe Kongresi i Peste t'a zgjedhe udheheqesine e vjeter heroike, e ne rend te pare shoket: Tito, Rankoviq, Kardelj dhe Gjillas, te cilet do te na udheheqin edhe ne t'ardheshmen ne ndertimin e socjalizmit, sikurse ne kane udheheqe pa u-trembe dhe si u ka hije komunistave,gjate luftes Nacjonal-çlirimtare. Komiteti i jone i dashtun Qendruer me shokun Tito ne krye nuk e ka lane Partin t'one e popujt t'one as ne ditet ma te veshtira te luftes Nacjonal-çlirimtare, por na ka mesue si duhet ma luftue, me e urrye dhe me e thye anmikun, e na nuk njofim asnji njeri tjeter qe do te na udhehiqte ma drejte e ma urte ne luften per ndertimin e socjalizmit se sa Komiteti i jone Qendruer, me shokun Tito ne krye.

Na mendojme se Rezoluta e Byros Informative asht prue ne baze te pohimeve te paverteta dhe te trillueme, se ajo asht shpifse dhe fyese per te gjithe neve, se nuk ka per qellim me e ndihmue Partin t'one, por, perkundrazi, me e shkatrrue unitetin e Partis s'one dhe me ia ule dinjitetin ne vend dhe perjashta, prandaj e hjedhim poshte si te ketille. Pajtohemi plotesisht me deklaraten e Komitetit t'one Qendruer.

Organizata e jone e Partis do te zhvilloje edhe ma tutje dashtunin vllaznore ndaj PK (b) te BRSS dhe partive tjera simotra, me gjithse ato ia kane bye nji pune jo-shoqnore e jo-komuniste ndaj Partis s'one.

Komiteti i vendit i betohet Kongresit se do t'a ruej me vigjilance kompaktesin e organizates se Partis ne Prishtine, do t'i perforcoje edhe ma rradhet komuniste, do t'a armatose nate e dite me theorine marksiste, ne menyre qe te kryhen sa ma lehte e sa ma shpejte te gjitha detyret qe na i parashtron Partija ne ndertimin e socjalizmit, e keshtu te provojme edhe nji here se jane te rrejshme te gjitha akuzat kundra Rartis s'one prej kahdo qe te rrjedhin.

Le të rrnojë Kongresi i Pete i PKJ!
Le të rrnojë shoku i lavdishem TITO-mburrje e Partis s'one!
Le të rrnojë prijsi i proletarjatit shoku Staljin!
Le të rrnojë Partija Komuniste bolshevike simoter e BRSS!

KOMITETI I VENDIT PKS
Prishtine

Ne diten e Kongresit „Trepça" e ka realizue normen me 120 perqind

Kolektivi punues i sipermarrjes „Trepca", tue e festue diten e Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis ka korre edhe nji fitore te re pune. Kete dite mbare kolektivi e ka realizue normen dhe tejkallue me 120 per qind. Minatori Shemsi Sulejmani, mbrenda 8 orve ka nxiere 39 tonelata mineral. Tue e festue kete dite ne shej fitoresh edhe ma te mdhaja puneje, ky kolektiv u ka shpalle gara te gjithe kolektivave punuese te kejij rangu ne mbare Vendin, per me e realizue planin vjetuer te prodhimit deri me 29 nanduer te k. v.— nji muej para afatit te parapame.

Organizimin e garave e ka ba si gjithnji aktivi i Partis se fabrikes dhe u-prine te gjitha ekipave dhe brigadave punuese ne zhvillimin e garave. Horizonti numer 5 e ka tejkalue premtimin e vet me 30 per qind dhe planin mujuer e ka realizue qysh ne njizet ditet e para te muejit. Dega e madenit e ka tejkalue premtimin me 100 per qind.

Vendin e pare e mbajne komunistat, sulmuesit dhe te dekoruemit me Urdhenin e punes, te cilet jane shembull nxitjeje per te gjithe te tjeret. Minatori Ignjac Jovanoviq e ka tejkalue premtimin e vet me 123 per qind, minatori Zakit ka marre persiper me i nxierre nji mije tonelata mineral e deri me 19 korrik ka nxierre 1100 tonelata.

Ne vend-shkriemjen e metaleve asht tejkalue plani i prodhimit me 5,5 per qind dhe jane ule shpenzimet e prodhimit per 2,5 per qind. Laboratorjumi i ka ule shpenzimet e prodhimit per 11 per qind.

Gjate kohes se Kongresit, komunistat dhe puntoret jashtë Partis jane tue ba nji lufte te rrebte me entuziazem dhe hov te pashoq per shtimin edhe ma te madh te prodhimit, per tejkalimin e normave dhe per plotsimin e planit vjetuer deri me 29 nanduer.

Frontistat e Lubizhdes e kane plotsue premtimin e dhanun ne ndere te Kongresit

Antaret e Frontit populluer te katundit Lubizhde te rrethit te Prizrenit e kane plotsue premtimin e vet te dhanun ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ. Kane pastrue dy puse uji, kane hape dy kanale per ujitje me nji gjatsi prej kater km, kane ndertue uren e katundit dhe nji krue. Ne keto punime jane dallue grate. Jane dhane gjithsejte 1400 ore pune vullnetare dhe 50 dite pune me kafshe terheqese—.

Frontistet e rrethit te Prishtines kane dhane 11700 ore pune vullnetare

Grate antifashiste te rrethit te Prishtines e kane plotesue obligimin e marrun persiper ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ. Ato kane dhane 11700 ore pune vullnetare ne ndertimin e shtepijave kooperative, tue dhane me ket menyre 3700 ore pune ma teper se sa kane premtue. Me inisjativen e ketyne jane hape tri strehime per femij prane kooperativave bujqesore te punes: „Nji Maj", „Ylli i Kuq" dhe „Fitorja". Ne keto vend strehime jane vendose 73 femij. Grate antifashiste te ketij rrethi e kane vizitue vend-verimin e femijve ne Komoran dhe me ket rast kane dergue dhurata te ndryshme.

Frontistat e rrethit te Prishtines kane marre pjese te gjane n'akcjonet e ndryshme te punes ne diten e hapjes se Kongresit

Ne diten e hapjes se Kongresit te Peste te PKJ, antaret e Frontit populluer te rrethit te Prishtines kane marre pjese te gjane n'akcjonet e ndryshme te punes. Vetem ne vend-ndertimin e shtepis kooperative ne Laplesella kane punue vullnetarisht 220 antare te Frontit. Frontistat e keshillit te vendit Fushe-Kosove gjithashtu kane marre pjese ne ndertimin e shtepis kooperative. Ne diten e pare te Kongresit kane punue 250 antare te Frontit populluer.

—„Kongresit te Peste i dergojme pershendetje te flakta e shoqnore dhe premtojme se ne t'ardhmen do t'i kryejme edhe ma me guxim te gjitha detyret qe do te na i parashtroje Partija e udhehequn nga shoku Tito"— thone ne telegram e tyne antaret e frontit te Laplesellies.

Grate e rrethit te Gjakoves gjate garave te para-Kongresit kane dhane 20.225 ore pune

FAG i rrethit te Gjakoves ne garat e parakongresit ka ndihmue mjaf realizimin e obligimevete Frontit populluer dhe detyrre te tjera te tij, si dhe t'obligimeve te veta te veçanta. Grate e rrethit te Gjakoves gjate garave te para-kongresit kane dhane 20.225 ore pune dhe ket obligim ato e kane tejkalue per 2 per qind. Kjo organizate ne ndertimin e rruges Deçan-Lloqan ka dergue 19 antare te veta, te cilat kane punue 10 dite dhe kane dhene ma se 1.500 ore pune. Ne pastrimin e enteve dhe ndertesave te tjera publike grate kane dhane ma se 2.700 ore pune dhe me kete e kane tejkalue obligimin e dhanun. Te rijve ne rrugen Deçan-Lloqan u kane dergue 192 kilogram paketa me gjana ushqimore, gja qe do te thote se obligimi i marrun asht tejkalue per 47 kilogram. Per diten e pionierve asht pregadite dreka per 70 pioniere he 100 frontiste te tjera. Kane fillue nga puna 8 kurse analfabetike me 115 gra, kane hjeke ferexhen 7 gra, dhe ne te gjitha katundet jane mbajte konferenca mbi regjistrimin e Huas popullore, hjekjen e ferexhes dhe Kongresin e Peste te PKJ. Me anen e obligimeve te dhanuna organizatat e FAG-es te rrethit te Gjakoves kane dergue 18 antare te veta ne pune ne fidanishten shtetnore, te cilat kane punue 10 dite dhe kane dhane 1.620 ore pune, e ne pune te ndryshme rreth korrjes ma se 8.000.

Grate e rrethit te Gjakoves ne kete menyre kane tregue se jane gati me e ndertue socijalizmin krahas mashkujt, ashtu siç i meson PKJ dhe shoku TITO.

Prizren:

Ne rrethin e Prizrenit ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ populli ka by masovikisht ne njisite punuese te Frontit, keshtu qe numri i antarve ne njisite punuese asht shtue, prej 1.524 ne 3.977. Keto njisi punuese punojne ne shtepijat kooperative, punimin e tokave te katundarve te vorfen, ndertimin dhe meremetimin e rrugeve, gelqerimin e shtepijave etj.

Gillan:

FAG i rrethit te Gillanit per ndere te Kongresit te Peste ka organizue dy grupe te gjana lexuese dhe 4 kurse analfabetike per gra shqiptare. Ne kurse tashma kane mesue me lexue dhe shkrue 20 shqiptare analfabete.

Ne katundin Brosane te rrethit te Gillanit asht hape shkolla e re ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ.

PEJE:

Organizatat e Frontit te katundeve Grabanic, Dollov, Drenove dhe Bokshiq ne rrethin e Pejes ndertojne ne ndere Kongresit te Peste uren e madhe mbi lumin Bistrica te gjate 40 metra. Kjo ure do te jete me randesi te madhe per komunikacjonin e ketyne katundeve.

Keshtu njerzit punues te Krahines s'one e pershendesin Kongresin dhe shprehin dashunin e pakufishme dhe besnikerin ndaj Partis Komuniste te Jugosllavis, udheheqsit te saj dhe mesuesit shokut Tito.

Liplan:

Shtresat punuese te Liplanit ne diten e pare te hapjes se Kongresit te Peste kane punue me vetmohimin ma te madh ne ndertimin e shtepis kooperative. Mbas punimeve te kryeme u-mbajte nji miting, ne te cilin foli shoku Bogdan Llabus.

Nga mitingu iu dergue nji telegram pershendetes Kongresit te Peste te Partis, ne te cilin ne mes te tjerash thuhet:

—Na komunistat dhe njerzit jashte Partis nga Liplani, nga akcjoni i jone i madh i punes i ndermarrun ne ndere te Kongresit te peste te Partis, i dergojme si Kongresit, ashtu dhe Komitetit Qendruer dhe Sekretarit te Pergjithshem te Partis s'one shokut Tito, pershendetjet t'ona qe rrjedhin nga dashnija dhe besimi i pakufishem ndaj udheheqsis s'one te Partis. Udheheqsija e Partis s'one na ka pri urte dhe guximshem prej fitores ne fitore. Nen udheheqjen e saje bolshevike popujt t'one e kane fitue lirin dhe pamvarsine ne luften Nacjonal — Çlirimtare, e sot e ndertojne socjalizmin. Na qindrojme ngultazi per bri Partis s'one dhe Komitetit t'one Qendruer me shokun Tito ne krye".

Deri me daten 24 k.m. jane regjistrue 133.853 000 dinare Hua popullore

Deri ne mbramjen e dates 23 korrik te k. v. jane regjistrue gjithsejt 133.853.000 dinare Hua popullore dhe ne kete menyre Krahina e jone e ka tejkalue premtimin e dhanun me 79,24 per qind.

Shoqnit kulturalo-artistike „RAMIZ SADIKU" dhe „RADNIÇKI" te Prishtines ne ndere te Kongresit

Ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ grupet teatrale te shoqnive kulturalo-artistike «Ramiz Sadiku" dhe "Radniçki" dhane çfaqje teatrale; shoq. "Ramiz Sadiku" çfaqi dramin e perkthyem „HAXHI LLOJA" dhe ajo e "Radniçkit" pjesen teatrale "MLADA GARDA". Ne fillim kori i "Radniçkit" i percjellun prej muzikes ushtarake kendoi «Internacjonalen", mandej kori i kombinuem i «Radniçkit" dhe i ushtris kendoi kange dhe marshe te ndryshme. Oficeri Peçenkoviq recitoi pjesen "Partija". Ne mbarim grupi folkloristik shqiptar, i perbame prej ndjekesave te kursit pedagogjik kendoi disa kange shqipe dhe luejti valle katundarçe.

Me gjithe mungesen e garderobes dhe te mjeteve tjera teknike sukses qe bukur i mire.

VLLAJKO BEGOVIQ

Ndërtim apo trathtim'i socjalizmit

Fushata qe zhvillohet ne vendet e demokracis popullore kundra udheheqesis se Partis dhe kundra Partis s'one, shpesh te çudite, pikerisht nga pohimet e rrejshme, thezat dhe konkluzat e pasakta, qe rrjedhin me kete rast. Ajo nuk ash kritike vllaznore, principjele, dhe ne qofte se asht e nevojshme, dhe as e rrebte e shokve udheheqsa, kritike qe te rrjedhe nga faktet dhe analizimi i tyne — ajo asht thjeshte fushate e pafre kundra Partis s'one. Kritiket i shmangen metodes marksiste-lenjiniste te parashtrimit dhe studimit te problemeve ata i perserisin pohimet e pa-arsyetueme dhe te pa-argumentueme te Rezolutes se Byros Informative, tue i marre ato si dogma. Te ban pershtypje se disa fjale e shprehi nga Rezoluta e Byros Informative thjeshte kombinohen ne menyre te ndryshme, u shtohet edhe nga dishka, dhe keshtu formohen theza e konkluza edhe ma te çuditshme. Kritiket t'one kane harrue nji nga principet themelore te materjalizmit djalektik se »njeriut i duhet me e tregue ne praktike te verteten, d.m.th. 'realitetin dhe fuqin e mendimit te vet« (Marksi). Prijsat e mdhaj te levizjes nderkombetare te puntorve prej Marksit deri ke Stalini e aplikojne, e mbrojne dhe e zhvillojne kete princip te materjalizmit djalektik dhe na tregojne se teorija »ka per baze te veten, qellim dhe kriter praktiken« (Stalin). Me gjithe ate kritiket t'one i ikin ngultazi realitetit te cilin e kritikojne, i mbyllin syte e veshet para tij dhe e harrojne dhe ate qe e kane pae e dijte. Prandaj, edhe kane ra pikrisht ne mbretnin e hipothezave dhe konkluzave te kurdisuna, fantastike e te pamundeshme.

Keshtu disa shoke perpiqen, qe n'ate menyre t'a kritikojne Planin t'one pesvjeçar dhe ndertimin e socjalizmit. Per shembull, shoku Zambrovski, Sekretar'i KQ te Partis Puntore Polake, ne mbledhjen e aktivit te Partis Puntore Polake, pohoi se »ne mbare koncepcjonin e Planit pesvjeçar çfaqet avanturizmi«, se ne Plan kemi »rithem ireal dhe te tepruem pa kuptim, i cili i damton interesat e popullit punues«; se ndjekim »politike te marre e reakcjonare t'autarkis« dhe »presypozojme se ne nji vend kaq te mbrapambetun e te vogel, siç asht Jugosllavija, mund te ndertohet socjalizmi pa ndihme, pa lidhje, pa aleancen e ngushte me BRSS e vendet e demokracis popullore«. Ne fund, se politika e Partis s'on nuk asht »as socjaliste, as popullore« dhe se »rrokullisemi ne greminen e shkeputjes dhe te trathtis se çashtjes se socjalizmit«. Sharpantje ne fletoren »Per paqe te qendrueshme, per demokraci popullore« pohon se kemi »program te rrejshem dhe avanturist te ndertimit te socjalizmit ne Jugosllavi me ndihmen e shteteve imperjaliste«. E antari i KQ te PK t'Austris, Firnberg, e çfryterzoi kete pshtjellim mendimesh, e perhapi mendimin e tij se „popujt e Jugosllavis ende nuk marrin ere per kooperativizem e industrin, e prandaj masat (qe na i nderrim) nuk çojne kah socjalizmi" etj.

Keta udheheqsa — me pergjegjesi politike — duhet te pakten deri diku t'a njofin Planin pesvjeçar dhe menyren e ndertimit te socjalizmit ne Jugosllavi, sidomos ne qofte se mbi kete duen me folo dhe me trillue akuza kaq te randa. Na e dijme mire se si asht shtrue Plani pesvjeçar dhe e dijme rrugen ne te cilen shkojme ne ndertimin e socjalizmit, e dijme realitetin t'one. Prandaj, tue iu permbajte ngultazi doktrines marksiste-lenjiniste se praktika asht kriter i se vertetes, na do t'i krahosojme akuzat e tyne me realitetin dhe do te konstatojme se sa te pathemelta jane ato.

Koncepsjoni i Planit pesvjeçar dhe tempoja e zhvillimit te prodhimit dhe ndertimit te vendit t'one

Plani i jone pesvjeçar asht perpilue para nji vjeti e gjyse. E kemi perpilue mbas studimit me kujdes te situates se mbrendeshme e nderkombtare. Me ket rast e kemi shfrytezue eksperiencen e madhe te Bashkimit Sovjetik ne planifikimin e ndertimin e socjalizmit dhe doktrinen e Lenjinit e Staljinit. U-pa se ekzistojne te gjitha kushtet e mbrendeshme dhe te jashteme per me kalue n'ekonomin me plan dhe ne ndertimin e socjalizmit. Keto kushte ke na jane te njoftuna pergjithsisht, dhe prap se prap jemi te detyruem qe t'i perserisim ketu. Keto jane:

E para. — Pushteti populluer, i cili nen udheheqjen e Partis s'one u-fitue ne luften Nacjonal-çlir'mtare dhe i cili, ne kushtet t'ona, e ka r[...]in qe e ka diktatura e proletarjatit ne ndertimin e socjalizmit ne BRSS. Ky pushtet popullue asht ne gjendje me e shtype resistencen e klikave kapitaliste te rxueme nga pushteti, me e organizue ndertimin e socjalizmit dhe me i bashkue turmat ne lufte per ket ndertim.

E dyta. — Egzistimi i sektorit ekonomik shtetnuer socjalist, i cili e perfshin krejte industrin, minjerat, kreditin, komunikacjonin dhe tregtin me shumice. Ne katund egziston kooperativizmi i fuqishem ne te cilin rolin udheheqes e kane katundaret punuesa dhe i cili se bashku me pasunit bujqesore te shtetit dhe stacjonet bujqesore te maqinave ka rol te randesishem ne perfshimjen e bujqesis ne plan ne mundesite e marredhanjeve te sotshme ekonomike.

E treta. — Aktiviteti, inisjativa dhe puna krijuese e klases puntore dhe e mbare popullit punues, e kane luejte dhe e luejne rolin vendimtar ne ndertimin e vendit dhe kane qene te gateshem me pranue dhe e kane pranue planin si çashtje te tyne.

E katerta. — Egzistimi i nji partije te ketille komuniste siç asht Partija Komuniste e Jugosllavis, e cila mundet me udheheqe klasen puntore dhe mbare popullin punues ne ndertimin e socjalizmit, e cila mundet me qene inisjatore, organizatore e udheheqese e luftes se popullit punues per ndertimin e socjalismit.

E pesta. — Egzistimi i Bashkimit Sovjetik dhe i vendeve te demokra[ci]s popullore Aleanca, bashkpunimi ekonomik e politik me keto vende.

Keto jane kushtet kryesore qe kane ba te mundshem kalimin n'ekonomin me plan dhe n'ofensiven per ndertimin e socjalizmit. A thue parashtrimi i Planit pesvjeçar dhe ndertimi i socjalizmit nen keto kushte ka qene avanturizem? Na mendojme, e kete e provojne edhe faktet, se nuk asht ashtu.

Gjithashtu dihet pergjithsisht se detyret kryeosore te Planit pesvjeçar jane likuidimi i mbrapambetunis ekonomike e teknike, ngritja dhe forcimi i fuqis ekonemike dhe mprojtse te Vendit, ngritja e mireqenjes se pergjithshme te njerzeve punues dhe zhvillimi i matejshem i sektorit socjalist t'ekonomis dhe vuemja e themeleve per ndertimin e shoqnis socjaliste.

Ku asht pra avanturizmi ne nji koncepsion te ketille te Planit pesvjeçar? Çfare rruge tjeter na kishim muejte me ndjeke? Mos me shkue ne ket rruge don te thote mos me krijue bazen ekonomike te pushtetit popullue, pushtetit te klases puntore dhe te turmave te tjera punuese; do te thote me e ba te pamundeshem perforcimin dhe zhvillimin e demokracis popullore me e lejue zhvillimin e kapitalizmit n'Jugosllavi dhe me ia çele dyert influences s'imperjalizmit. Kjo do te thonte trathti ndaj luftes se popullit t'one dhe trathti ndaj luftes per socjalizem. Mos me shkue ne rrugen qe na jemi nise do t'ishte ne realitet avanturizem, do me thane bastardhim i demokracis pupullore dhe trathti ndaj socjalizmin.

A thue asht e teprueme dhe ireale rithmi i zhvillimit te prodhimit dhe i ndertimit qe asht shtrue ne Planin pesvjeçar? Na mendojme se jo, e kete e provon edhe praktika se nuk asht ashtu. Kete rithem neve na e imponojne nevojet qe te dalim sa ma pare nga mbrapambetja ekonomike e teknike dhe t'a realizojme industrijalizimin. Pa kete nuk mundemi me shpejtue zhvillimin e gjith ekonomis me e zbatue transformimin socjalist te bujqesis dhe me e ngrite nga themelet standardin jetesuer te njerzve punuesa. Realizimin e rithmit te shtruem e bajne te mundeshem edhe kushtet objektive dhe ata subjektive.

Edhe ke na, perpara, kane egzistue mendime te ndryshme mbi rithmin e permbushjes se Planit. Praktika e tregoi shpejt se rithmi i planifikuem asht real dhe i mundeshem, ashtu siç e tregoi praktika se edhe vete plani asht real. Ne vjetin e pare, 1947, siç dihet, plani u-plotsue dhe u-tejkalue. E po keshtu ngjau edhe ne gjysen e pare te vjetit 1948. Jo vetem kaq. Plani i pare vjetuer e sidomos dyti, simbas vllimit te tyne jane ma te mdhaj se sa e kerkon permbushja e Planit pesvjeçar. Plani i vjetit 1948 ne disa dege e prodhime asht aq i madh sa i tejkalon detyret qe jane paraqite ne Planin pesvjeçar per vjetin 1951. Keshtu, per shembull, plani i industris se drunit perfshine 140 per qind nga plani per vjetin 1951 (kete e kane kerkue nevojet e shtimit te eksportimit dhe ndertimit), plani i lekurave dhe i mbathjeve 108,7 per qind prodhimi i kazanave t'avullit 176 per qind, prodhimi i tullave 149 per qind. Plani i prodhimit te nji numri te madh prodhimesh me randesi, ne vjetin 1948 asht afer 50 per qind ma i madh nga detyret qe duhet te kryhen ne Planin pesvjeçar. Keshtu, per shembull, prodhimi i vagonave te transportit 52 per qind, pllugjeve 55 per qind, maqinave fshise 59 per qind, çimentos 61 per qind, qymurit 74 per qind, çelikut 46 per qind, i te gjithe pelhurnave te pambukut 84 per qind, pelhurnave te leshit 72 per qind, xhamave te ndryshem 54 per qind etj. Don me thane se praktika tregon qe Plani pesvjeçar asht real, se rithmi i tij asht real dhe se mundet me qene bile edhe ma i madh, sepse plani qyshtash asht tejkalue mjaft.

Per realizimin e Planit nevojiten padyshim perpjeke dhe sakrifica, dhe populli i jone i ban keto perpjeke e sakrifica. Nuk asht gja e lehte me e ndertue socjalizmin ne nji vend te mbrapambetun ekonomikisht dhe te shkatrruem nga lufta. Bashkimi Sovjetik na ka dhane shembullin se si duhet me qene i gatshem per Perpjeke e sakrifica ne ndertimin e socjalizmit. „Asht deshte — thote shoku Stalin — me e krijue industrin e klases se pare. Asht deshte me e drejtue ket industri ne menyre qe ajo te jete ne gjendje te t'organizoje teknikisht jo vetem industrin, por edhe bujqesin edhe komunikacjonin t'one hekurudhuer. E per kete arsye asht deshte me ba sakrifica dhe me ba kursimin ma rigoroz ne çdo gja, asht deshte me kursye edhe n'ushqim, edhe ne shkolla, edhe ne manifakture, per me u-mbledhe mjetet e nevojshme per krijimin e industris. Rruge tjeter per zhdukjen e uris ne fushen e teknikes nuk ka pase. Keshtu na ka mesue Lenjini dhe ne keto gja kemi shkue mbas gjurmave te Lenjinit«. Pa tjeter se neve prap se prap na asht ma e lehte me e ndertue socjalizmin, sepse egziston BRSS dhe vendet e demokracis popullore, egziston bashkpunimi ekonomik e politik me to. Na kemi muejte qe perveç sukseseve te mdhaja ne ndertim, t'a ngrejme prodhimin e artikujve te konsumit te gjane mbi prodhimin e vjetit 1939, qe per çdo vjet e ngrejme gradualisht standardin jetesuer te popullit punues dhe e forcojme gjithnji ma teper principin socijalist te dhanjes ne base te punes.

Rezulton pra, se ne Planin t'one dhe rithmin e ndertimit nuk ka avanturizem. Avanturizem mund te gjindej ma pare ne nji kritike te ketille kaq pa-pergjegjes te ndertimit te socijalizmit ne nji nga vendet si motra.

Çashtja e bashkpunimit me BRSS e me vendet e demokracis popullore ne ndertimin e socjalizmit

Ne Jugosllavi teorikisht nuk asht parashtrue e as praktikisht nuk asht zbatue ndertimi i socijalizmit, pa bashkpunimin e lidhjen me BRSS e vendet e demokracis popullore, dhe as qe asht aplikue politika e autarkis. Kete, per heren e pare e muerem vesh nga rezoluta e Byros Informative dhe po e ndigjojme nga ata te cilet e perserisin ate. Kur asht fjala mbi theksimin dhe propagandimin e nevojes se bashkpunimit ekonomik e politik me BRSS e vendet e demokracis popullore, nuk kemi se si te japim citate nga fjalimet, deklaratat e artikujt e udheheqsave t'one te Partis e te Shtetit, sepse ato do te duhesh me i permende gadi te gjitha. Ata na kane tregue dhe na kane mesue vazhdimisht se ne ndertimin e socijalizmit dhe luften kundra imperjalizmit asht i nevojshem ky bashkpunim. Kete gja ata e kane zbatue edhe ne praktike. Mbi kete flasin edhe marreveshtjet e paktet e shumta me ato vende. Te permendim vetem disa qe kane lidhje direkte me Planin pesvjeçar dhe me ndertimin e socijalizmit, siç jane: marreveshtje mbi bashkpunimin ekonomik me BRSS, marreveshtja mbi bashkpunimin ekonomik me Republiken e Polonis, pakti investicjonal me Republiken e Çekesllovakis, pakti investicjoneve Ungarin etj. Kete lidhje te jashtme ekonomike jane pjese perbase te Planit dhe jane perpunue ne sejcilin plan vjetuer. Ne substance ato jane koordim i planeve ekonomike.

Permbushja e Planit te lidhjeve ekonomike bahet kryesisht me anen e tregtis se jashtme ne shkembim mallnash. Me vendet e demokracis se re jane lidhe marreveshtje te cilat sigurojne shkembimin e mallnave me afate te gjata dhe ne baze te Planit. Pjesemarrja e Jugosllavis ne kete bashkepunim ekonomik tregohet nga keto shifra: ne qofte se e marrim eksportimin dhe importimin se bashku, dhe vjetin 1946 e shenojme me indeksin 100, atehere ne vjetin 1947 qarkullimi i tregtis se jashtme asht shtue ne 370, e simbas planit per vjetin 1948 asht 1088. Kjo tregon se si Jugosllavija i zhvillon gjithnji ma teper lidhjet ekonomike me vendet e tjera dhe do t'i zhvilloje padyshim edhe ma tutje. Kjo gjithashtu tregon se sa e pathemelte asht akuza mbi politiken e autarkis ne Jugosllavi. Shifrat tregojne edhe fakte tjera: ne vjetin e kaluem 53 per qind te mbare importimit t'one dhe 56,9 per qind te mbare eksportimit te Jugosllavis, u perkasin BRSS-it dhe vendeve te demokracis popullore. Ne mes te vendeve te demokracis popullore ne kete pikepamje neve mbajme vendin e dyte. Ne shkembimin reciprok ne mes te vendeve te demokracis popullore n'importimin e zame vendin e pare 32,2 per qind, dhe n'eksportim vendin e dyte me 40,2 per qind mbas Rumanis, e cila e zen vendin e pare me 40,9 per qind.

(Vazhdon ne faqen e trete)

Ndertim apo trathtim'i socjalizmit

(Vijon nga faqja e dyte)

Prej importimit te pergjithshem te Jugosllavis se vjeter (me 1938) Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te sotshme te demokracis popullore u ka takue vetem 16,84 per qind. Don me thane Jugosllavija e re, per ndertimin e socjalizmit, ne lidhjet ekonomike, mbeshtetet ne BRSS dhe ne vendet e demokracis popullore. N'importimin e mallit prej vendeve kapitaliste per vjetin 1947 Jugosllavija merr pjese me 46,7 per qind t' importimit te saje te pergjitheshem, ndersa Polonija merr pjese me 52,2 per qind, Ungarija me 60,7 per qind, Çekosllovakija me 80,5 per qind etj. Keshtu flasin faktet mbi bashkepunimin ekonomik, ku shifet shkalla e pjesemarrjes ne te.

Na nuk e konsiderojme te padrejte me pase lidhje ekonomike me vendet kapitaliste, kur ne lidhje me kete mbahen parimet qe i ka Bashkimi Sovjetik ne tregtin e tij te jashtme. Keto jane: monopoli shtetnuer i tregtis se jashtme, respektimi i sovranitetit te shtetit t'one, barabarsija ne bashke-fjalime e lidhje paktesh dhe vuemja e tregtis se jashtme ne sherbim te ndertimit te socjalizmit. Me vendet kapitaliste qe duen me iu permbajte ketyne parimeve na mund te bajme tregti, sidomos atehere kur nuk egziston mundesija e shkembimit te mallit n'anen tjeter. Prandaj pse asht nevoja me e akuzue bash Jugosllavin se don me ndertue socjalizmin pa vendet demokratike me ndihmen e vendeve imperialiste, siç ban Sharpantje? Shoku Sharpantje don me u-ba qorr e mos me e pa faktin. Na kemi arrijte pamvaresin e Vendit t'one, kemi rindertue Vendin dhe po e ndertojme socjalizmin ne lufte kundra pretendimeve dhe sulmeve t'imperjalizmit. Veç Bashkimit Sovjetik, a ka ndonji vend europjan qe u ka qene ekspozue grushteve dhe sulmeve nga ana e imperjalistave mbas luftes se sa Jugosllavija? A ka ndonji vend qe, mbas Bashkimit Sovjetik, t'i kete ba rezistence aq te qendrushme dhe lufte, krahas me BRSS, kundra ketyne sulmeve t'imperjalistave? Na e kemi formue qendrimin t'one ndaj imperjalizmit, jo vetem tue i studjue veprat e Lenjinit e Staljinit, por edhe gjate asaj lufte. Prandaj Sharpantje, kur pohon se na duem me ndertue socjalizmin me ndihmen e shteteve imperjaliste, tregon se sa pak ndjenja pergjegjesije ka per fjalet e tija. Kush do te na binde se kjo nuk asht nji çpifje e llogaritun?

Me rastin e realizimit te lidhjeve t'ona ekonomike me vendet e demokracis se re ekzistojne ndonji here dhe mund t'egzistojne disa mosmarreveshtje ne pikpamje te formave te bashkepunimit ekonomik. P. sh. na ndjekim parimin, e kete e ka vertetue praktika e deritashme, se nen kushtet e sotshme ma e mira forme e bashkepunimit ekonomik asht ajo qe mbeshtetet ne planet ekonomike dhe harmonizimin e tyne, e realizohet me ane te tregtis se jashtme. Egzistojne, propozohet, e diku edhe jane shenue ne marreveshtje edhe format tjera, te cilat akoma duhet me i studjue e perpunue per aplikimin praktik.

Deri vone ka egzistue dhe akoma mund te gjindet mendimi i tille se Jugosllavija asht vend agrar dhe si e tille duhet te mbetet, se ajo duhet t'u liferoje vendeve te zhvillueme industrialisht lande te para dhe gjana ushqimore, e ato, Jugosllavis artikuj te gatshem industrijale te konsumimit te gjane. Per ne kjo don te thonte me hjeke dore nga industrijalizimi i Vendit t'one. Na e dijme se pa industrin dhe me teknike te mbrapambetun nuk mund te ndertohet socjalizmi, na dijme siç na meson Staljini, se industrija asht faktori kryesor ne te tane sistemin e ekonomis popullore, se ajo i prine te tane ekonomis popullore, tue perfshi ketu edhe bujqesin. Prandaj na nuk mund te hjekim dore nga industrijalizimi i Vendit t'one.

Ndamja e shteteve ne vende industrijale dhe agrare e ka kalue kohen e saje atje ku ndertohet socjalizmi. Ne ndertimin e socjalizmit vlene, si element perbase i randesishem, parimi staljinjan i zhvillimit kompleks te ekonomis krahinave dhe vendeve te ndryshme. Qe ekonomija e ndonji krahine ase vendi qe mund te zhvillohet shpejte, qe te çfrytezohen me sukses pasunite natyrore te vetat, atehere ai vend mundesisht duhet te kete çdo gja qe i nevojitet per ket qellim, ne rend te pare industrin e vet, e mbi te gjitha industrin e rande. Bashkepunimi per ndertimin e socjalizmit nuk mund te mbeshtetet ne shkeljen e ketij parimi.

Mendimi i shokut Firnberg se popujt e Jugosllavis s'marrin ere per kooperativizem e industri e ka rranjen e tij nga kohnat e kahershme dhe asht mjaft i vjetruem. Ky mendim ka egzistue ne monarkin Austro-Hungareze. Me kete asht e justifikueme sepse vendet t'ona jane qite ne poziten e gjysem-kolonive, te cilat duhet te liferojne lande te para dhe fuqi puntore per ngritjen e industris n'Austri. Persa i perket kooperativizmit, disa republika te Jugosllavis nuk mbesin mbrapa Austris per kah traditat.

Asht çfaqe edhe mendimi i tille siç asht ai i H. Kortiskut se jemi „nacjonalista megalloman" sepse ndertojme qytetin e filmave dhe industrin e filmave, mbassi egziston industrija sovjetike e filmave. Na e çmojme permbajtjen ideologjike dhe vleren artistike te filmave sovjetike dhe mesojne prej ketyne, por kemi te drejte dhe e kemi per detyre me e zhvillue edhe kulturen e popujve t'one. „Çdo komb, — thote shoku Staljin — qofte i vogel ose i madh, ka veçorinat e veta, specificitetin e vet, qe asht karakteristike vetem per te e qe nuk egziston ne kombet tjera. Keto cilesina perfaqesojne te kontribut qe e jep çdo komb ne thesarin e perbashket te kultures botnore, e ploteson dhe e pasunon. Ne ket pikpamje, te gjitha kombet — te mdhaja e te vogla — gjinden ne te njajten pozite dhe seicili komb ka te njajten randesi si çdo komb tjeter". Ne driten e ketyne mendimeve te nalta shifet se çfar rruge kane marre ata qe e kane marre mbi vehte rolin me na qite ne rruge te drejte.

Ne ket lushate dhe turbullim idenash dhe kuptimesh qe asht krijue ne lidhje me paraqitjen e Rezolucjonit te Byros informative, asht tregue mospjekunija ideologjike dhe mungesa e principjelitetit ke disa shoke udheheqsa ne partinat simotra. Asht pa edhe se ket turbullim disa e çfrytezojne me fute idena te huaja shoviniste nen mbulojen e parimeve te marksizem, lenjinizmit dhe mprojtjes s'ides se ndertimit te socjalizmit.

Neve na asht e afert dhe e kjarte ideja e bashkpunimit te popujve ne ndertimin e socjalizmit dhe mendojme se do t'ishte dobi shum e madhe sikur ne vend t'akuzave te pathemelta dhe shkaktimit te trubullimit, te banej nji analize serjoze e bashkpunimit te deritashem, sikur te shqyrtoheshin format e deritashme te ketij bashkpunimi dhe te kerkoheshin, po qe e nevojshme, format tjera ma te mira. Çdo vend i demokracis popullore ka deri diku specificitetet e veta ne ndertimin e socjalizmit dhe eksperijencat e veta, me gjithse ende te vogla. Rezultati i nji analize te ketille do te kishte randesi te madhe per ndertimin e socjalizmit ne keto vende, e gjithashtu edhe per ato vende qe do te hyjne ne ket rruge ne t'ardhme. Po qe puna rreth ketij problemit, atehere pse nuk shtrohen çashtjet haptazi dhe principjelisht, atehere pse qe e nevojshme me trillue akuza dhe me i akuzue udheheqsat, Partin dhe mbare popullin, kur ata e kane tregue gatshmenin e tyne qe me pune t'a japin kontributin per fitoren e socjalizmit ne vendin e vet dhe ne mbare boten?

Disa udheheqsa politike mund t'a çfrytezojne besimin e antarve te Partis se vet dhe t'ua paraqesin kritiken e akuzat e ketij llojit kundra udheheqsin se Partis s'one dhe Partis s'one. Mund t'a fitojne edhe pelqimin e tyne, sepse ata nuk e dijne gjendjen e vertete te çashtjes. Por, ata nuk mund te kerkojne prej nesh qe na, ne baze t'akuzave te tilla, t'a perçajme bashkimin e Partis s'one te farkuem ne lufte, me e perjashte udheheqsine t'one te Partis e shtetit nen udheheqsin e te cilës kaluem ditet ma te veshtira dhe korrem fitoret ma te veshtira ne historin t'one. Na e shofim per dite punen e udheheqsave t'one te Partis. E ndjekim çdo fjale te tyne, i zbatojme ne praktike, dhe praktikisht shofim drejtesin e tyne. Prandaj mund te pohojme me kaq siguri dhe kaq kompaktesisht se rruga ne te cilen ata na prijne asht e drejte, se politika te cilen e ndjekin ata asht socjaliste. E, kritika dhe akuzat qe vijne nga ana e disa udheheqsave te partive si motra, perkundrazi neve na bindin ne pathemeltesin dhe padrejtesin e gjesteve te tyne dhe qendrimit te tyne. Per ket gja ata na japin mjaft prova. Sikur te shkojshim ne rrugen qe na e tregojne ata, atehere me te vertete do t'ishim asi avanturistash si perpiqen me na paraqite keta kritike para popullit te tyne.

Vendi i yne si dhe vendet tjera te demokracis popullore, mund t'egzistoje si i tille dhe te zhvillohet jo vetem tue ndertue socjalizmin simbas parimeve qe i kane dhane Marksi, Englesi, Lenjini e Staljini, tue mbete n'aleancen vllaznore me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet tjera te demokracis popullore dhe tue e zhvillue matutje ket aleance. Na jemi te vetedijshem per ket dhe prandaj i drejtojme te gjitha forcat t'ona drejt ndertimit dhe forcimit te socjalizmit ne Vendin t'one dhe do te vazhdojme te bajme gjithçka qe mvaret prej nesh per forcimin e lidhjeve dhe bashkpunimit ekonomik me BRSS dhe me vendet e demokracis popullore. Kjo nuk asht rruge e trathtis, por rruge e ndertimit te socjalizmit. Kjo asht rruge historike e zhvillimit te cilen nuk mund t'a ndale kurrkushi.

Mbi statistiken dhe evidencen n'organizatat e Frontit populluer

Ne shum organizata te Frontit populluer nder keshillat e rrethit dhe te vendit, mbajtja e statistikes dhe e evidences nuk asht e rregullt, e kjo pengon shtruemjen dhe zgjidhjen e problemeve n' organizaten e Frontit t'one populluer.

Roli dhe randesija e mbajtjes se statistikes dhe e evidences, per shtruemjen e punes me plan, kuptohet nga fjalimi i mbajtun prej shokut Tito me rastin e vitit te ri 1948, ku thuhet se: „Pa statistike e evidence te rregullt asht e pamundun puna me plan". Me gjithe ket, disa organizata te Frontit populluer nder rrethe, ende nuk i kane kushtue randesin e duhun punes ne ket drejtim. Shume gabime nder sektoret e ndryshem te punes te Frontit t'one populluer kane rrjedhe edhe sepse statistika dhe evidenca asht e dobet. Ka pase raste qe disa prej organizatave te Frontit populluer te rretheve kane s h e n u e shifra me h a m e n d j e, qe nuk i jane p e r g j e g j e gjendjes se vertete te punes se kryeme, e kjo rrjedhe nga mosmbajtja e evidences se perditshme ne rregull. Ne te vertete, antaret e Frontit populluer t'atyne rretheve kane punue aktivisht, porse mungon regjistrimi i punes te bame, keshtu qe forumet pergjegjese nuk kane dijenin e nevojshme mbi punen, sukseset dhe gabimet e tyne e prandaj e kane veshtire edhe me u ndihmue. Te gjitha organizatat e frontit populluer referatet e punes dhe statistikat mujore, duhet t' ia dergojne Frontit Krahinuer deri me 5 te çdo mueji, kurse disa prej tyne presin me ua kujtue here pase here, se per n d r y s h e e lane krejte ne harrese. Ne ket rast shembullin ma konkret e kemi n,organizaten e Frontit te rrethit te Suharekes, e cilla nuk e dergon referatin dhe statistiken mujore, para se me ia kujtue disa here.

Organizates se Frontit populluer te rrethit te Pejes, per pese muej rresht, as qe i ka ra ndermend me ia dergue Frontit Krahinuer pasqyren statistikore dhe referatin mujuer.

Ma dobet ne mbajtjen e evidences dhe ne mbajtjen e pasqyrave statistikore mujore qendron puna ne keto rrethe:

Kamenice, Prishtine dhe ne qytetin e Pejes, kurse ma mire qendron puna ne ket drejtim n'organizatat e Frontit populluer te rretheve: Gillan, Prizren Podujeve, Serbice, Lipljan dhe ne qytetin e Prizrenit.

Vonesa e dergimit te statistikave dhe e referateve mujore te Frontit populluer te Krahines rrjedhe nga se mungon evidenca e perditshme e punes nder organizatat e Frontit populluer nder rrethe. Pra pa nji evidence te rregullte te punes se perditshme nuk mund te bahen ndermarrje, per me permiresue gabimet e leshueme.

Prandaj, n'interesin e mbarevajtjes se punes nder organizatat e Frontit t'one populluer, duhet me i dhane fund nji here e mire te metave dhe leshimeve te punes s'evidences dhe me e organizue si duhet ate ne ket drejtim. Tash e mbrapa, nuk duhet me lejue qe pasqyrat statistikore dhe referatet mujore t'i dergohen me vonese Frontit Krahinuer mbassi nji veprim i tille e pengon nji pjese te mire te punes se gjishanshme te tij.

Nga obligimet e marruna ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ

Peje:

FAG i rrethit te Pejes i ka plotesue obligimet e veta te marruna per ndere te Kongresit te Peste te PKJ. Me planin e obligimeve per shembull asht parapa qe per ndere te Kongresit te veshen disa femij ne mbare rrethin, ndersa te gjitha organizatat e vendit kane veshe te pakten nga dy femij, e disa nga dhete e ma shum, siç ka ba organizata e Fag-es ne Baran, e cila ka veshe 12 femij te vorfen. Grate e rrethit te Pejes kane marre pjese masovike ne regjistrimin e Huas popullore. Ma se 65 per qind t'antareve te Fag-es te rrethit te Pejes kane regjistrue Huan popullore. Milka Shaliq nga Vitomirica ka regjistrue ne Hua popullore shumen e pergjitheshme te kursyeme prej 30.000 dinareve. Ajo me ate rast ka thane se keto te holla i jep per realizimin e Planit pesvjeçar dhe vetem se i vjen keq qe nuk mundet me dhane ma teper.

LIPLAN:

Edhe FAG i rrethit te Sitnices ne garat e parakongresit ka arrijte rezultate te dukshme. Ato, ne ndertimin e shtepijave kooperativiste, hjedhjen e drithnave dhe nder akcione te tjera kane dhane ma se 5.000 ore pune.

MITROVICE

Ne diten e pare te hapjes te Kongresit te Peste te PKJ, ne Mitrovice u-mbajte nji miting, ku muerren pjese ma se 4000 vete-puntore intelektual, qytetar e qytetare. Te gjithe e pershendeten Kongresin dhe shprehen deshiren e tyne te zjarte se do t'a vazhdojne edhe ma me vendosmeni rrugen e ndertimit te socjalizmit ne Vendin t'one dhe se do ti kryejne te gjitha detyrat qe ka me ua ngarkue Kongresi

Edhe nji ilustrim i padrejtesis s'akuzes se Byros Informative

Fyemja ma e prekshme per njerizit t'one asht ajo qe thote se Partija Komuniste e Jugosllavis i edukon masat popullore ne frymen antisovjetike, se deshiron me i mshefe dhe me i nenqmue meritat e Bashkimit Sovjetik ne luften e kalueme, se don me e nenqmue rolin e Bashkimit Sovjetik si udhehoqes dhe fuqi themelore e Frontit anti-imperjalist.

Me provue ne Jugosllavi, se tek na nuk ndiqet propagande anti-sovjetike, do te thoshte me vertetue se dy e dy bajne kater, se dielli del ne lindje e perendon ne prendim. — Prandaj keta rreshta u drejtohen ne radhe te pare, kritikesave t'one, qe ata t'i bluejne me mend.

T'a shiqojme se parit mjetin ma masovik t'agitacjonit dhe te propagandes, shtypin e dites. Sa shkruen „Borba" per Bashkimin Sovjetik, sa i njofton masat Jugosllave ma suksesat e Pjatiletkes se IV-te Stalinjane, sa e popullarizon politiken e jashtme te Bashkimit Sovjetik? Ne ç'mase e kryen „Borba" kete detyre ne krahasim me organet e Partive Komuniste te Bullgaris, Rumanis, Ungaris, Çekosllovakis, Italis dhe Frances. Qellimi i ketij artikulli asht me kritikue te shkruemit e ketyne gazetave mbi Bashkimin Sovjetik, ase me i kendue kange lavdije „Borbes", por me i majtene ne shesh faktet lakuriqe, te cilat flasin vete.

Simbas shenimeve statistikore te Drejtoris s'Informatave prane Qeveris se RFPJ, „Borba", gjate vitit 1947, ka shkrue per Bashkimin Sovjetik, per politiken e tij te jashtme, per suksesat e njerzve sovjetike ne perforcimin e atdheut te tyne socjalist — ma teper se sa „Rabotniçesko Delo" — Organ i P.K. te Bullgaris, se sa „Skanteia", organ i P.K. te Rumanis, se sa „Sabad Nep"-organ i P.K. te Hungaris, se sa „L'ymanite"-organ i P.K. te Frances, se sa „Unita" — organ i P.K. t'Italis.

Lexuesve te vet ne Jugosllavi „Borba" u ka dhane ma teper materjal mbi Bashkimin Sovjetik se sa organet e Partive te nalepermendura lexuesve ne vendet e tyne me perqindje qe sijon:

Nga „Rabotniçesko delo" per 13,8 % ma teper;

Nga „Skanteia" per 137 %

Nga „Sabad Nep-i" per 155 %

Nga „Rude Pravo" per 208 %

Nga „Unita" per 236 %

Nga „Ymanite" per 850 %

Kjo statistike, ma hollesisht duket keshtu:

„Borba" ia ka kushtue Bashkimit Sovjetik 7,4 % te vend-shkrimit te saj: politikes se jashtme te BRSS-it 4,7 % e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 2,7 %, informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 310 numrave te „Borbes" te vitit 1947.

„Rabotniçesko delo" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 3 %, e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 3,5 %, gjithsejt 6,5 %. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 267 numrave te „Rabotniçesko Delo-s" te vitit 1947.

„Skanteia" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 1,30 %, e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 1,77 %, gjithsejt 3,07 %. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 227 numrave te „Skanteia-s" te vitit 1947.

„Sabad Nep-i" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 1,48 % e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 1,38 %, gjithsejt 2,86 %. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 230 numrave te „Sabad Nep-it" te vjetit 1947.

„Rude Pravo" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 0,41 % e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 1,96 %, gjithsejt 2,37 %. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 304 numrave te „Rude Pravos" te vjetit 1947.

„Unita" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 0,9 %, e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 1,3 %, gjithsejt 2,2 %. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 178 numrave t' „Unitas" te vjetit 1947.

„Ymanite" i ka kushtue politikes se jashtme te BRSS-it 0,26 per qind, e jetes se mbrendeshme te BRSS-it 0,62 per qind. Gjithsejt 0,88 per qind. Informatat jane mbledhe ne baze te shqyrtimit te 272 numrave te „Ymanite-s" te vjetit 1947.

Nga keta shembuj shihet se si partija Komuniste e Jugosllavis, nepermjet t'organit te vet, „Borbes", u a ka skjarue masave popullore te vendit t'one gjate vjetit 1947, rolin e Bashkimit Sovjetik si ne çeshtjen e politikes se jashtme, ashtu edhe ate te ndertimit socjalist; keta shembuj jane edhe nji prove e qendrimit te pergjithshem te Jugosllavis se re ndaj Bashkimit Sovjetik.

Ky qendrim nuk ka ndryshue as ne vitin 1948, as qe mund te ndryshoje. Do t'a tregojme edhe nji shembull nga sektori tjeter i agitacionit dhe propagandes; do t'i paraqesim shenimet se sa libra sovjetike jane perkthye dhe botue ne Jugosllavi per kater muejt e pare te ketij viti, tue krahasue me numrin e librave qe jane botue njikohesisht ne nji nga vendet tjera te demokracis popullore, p. sh. ne Çekosllovaki.

Per keta kater muej te ketij viti ne Jugosllavi jane perkthye 287 libra nga gjuhet e hueja, e ne Çekosllovaki 277 libra (tue e llogarite Sllovakine vetem per kallnduer u hueh).

Nga ky numer, ne Jugosllavi 225 jane libra sovjetike ase 78,39 % te numrit te pergjithshem te librave te perkthyeme ne te gjitha gjuhet e, ne Çekosllovaki jane perkthye vetem 57 libra sovjetike, ose 21,2 %.

Ne Jugosllavi per kater muejt e pare te ketij vjeti jane perkthye vetem 34 vepra angleze, amerikane dhe franceze dhe keto vetem klasike ase 9,80 % d.m.th. gadi 8 here ma pak se sa libra sovjetike, nderse ne Çekosllovaki situata asht e kundert. Per kater muejt e pare te ketij vjeti ne Çekosllovaki jane perkthye gjithsejt 124 vepra angleze, amerikane dhe franceze dhe bile jo vetem klasike—ma 60 % te numrit te pergjithshem te perkthimeve te botueme, d.m.th. 3 here ma teper libra angleze-amerikane dhe franceze se sa sovjetike.

Ne maj proporcioni asht rritë edhe ma teper. Ne Jugosllavi, nga numri i pergjithshem i perkthimeve te botueme, jane botue 81,97 % perkthime sovjetike, kurse angleze, amerikane dhe frenge gjithsejt 6,1 %. Ndryshe, ne Çekosllovaki, prej majit deri ne kater qershuer te ketij viti nga perkthimet sovjetike jane botue gjithsejt 15,8 %, kurse nga ato angleze, amerikane dhe franceze 59,6 % tue perfshi edhe librin e trockistit me damke André Bretonit „Mbi realizmin nderkombetar", librin e ekzistencialistit freng Anui-it, „Antigona" dhe kesosojt.

Te kalojme ne shembullin e trete, ne mjetin ma te fuqishem t'agitacionit dhe te propagandes, ne film. Si qendron Jugosllavija ne ket pikpamje? A asht kujdesu e Partija Komuniste e Jugosllavis qe t'u japi masave Jugosllave sa ma teper filma sovjetike apo amerikane e filma nga Bashkimi Sovjetik te cilet dallohen me pasterin ideologjike dhe artistike, tregojne patriotizmin e njerzve sovjetike ne luften çlirimtare, e sod ne ndertimin socialist, zhvillojne te shiqueshi ndjenje bujare, pasqyrojne barazine e popujve ne Bashkimin Sovjetik, filma qe me nji fjale i armatosin masat t'ona ne lufte per socjalizme — apo filma amerikane, te cilet, ne shumicen ma te madhe, pasqyrojne urrejtjen midis racave, lavdojne eksploatimin e njerit mbi njerin, shtyjne rinin ne krime?

Ç'fare politike zbaton ne kete pikpamje Jugosllavija, e ç'fare vendet e tjera te demokracis popullore?

Kete here do t'a marrin si shembull Hungarine. Ne Kronikën e jetes kulturale ne Hungari", prej prillit te vitit 1948 asht sjelle statistika mbi numrin e filmave te jashtem, te cilet jane çfaqe ne Hungari prej vitit 1945 deri ne vitin 1947. Nga kjo statistike shihet se ne Hungari ma se shumti çfaqen filma amerikane dhe bile jo vetem ne vitin 1945, por edhe ne vitin 1947. Ne vitin 1945 ne Hungari jane çfaqe 43 filma amerikane ose 54,42 % te numrit te pergjithshem te filmave te çfaqun, nderse filma sovjetike jane çfaqe gjithsejt 29 ose 36,78 %. Ne vitin 1946 numri i filmave amerikane ne Hungari asht rrite gadi dyfish, ne 81 ose 55,48 %, kurse filma sovjetike jane çfaqe gjithsejt 37, ose 25,35 %.

Ajo qe asht ma e pakuptueshme, ne vitin 1947, kur partija Komuniste ne Hungari i ka perforcue bukur shum pozitat e veta ne krahasim me vitet e maparshme, Asht fakt qe numri i filmave amerikan u ka mbajte shihen njajtë e se bashku me filmat franceze dhe angleze dhe filmat e vendeve tjera kapitaliste ka mbrrijte perqindjen e pergjithshme 62,7 %. Kurse nga ana tjeter jane çfaqe vetem 54 filma sovjetike, ose 16,9 % nga numri i pergjithshem i filmave.

Se gjitha keta, shokët t'ona hungareze i lavdojne botenisht me kete gjendje. Edhe agjensija telegrafike hungareze e ka shpalle me 15 maj te ketij viti ket statistike te „Kronikes se jetes kulturale ne Hungari", tue ia shtue kete komentim:

„Ku asht fakti ma i kjarte se sa asht e vertete prralla mbi „perden e hekurit", e cila propagandohet aq shum ne vendet perendimore."

E si asht tek ne perpjestimi midis filmit sovjetik dhe amerikan?

Ne vitin 1945 ne Jugosllavi jane çfaqe 45 filma sovjetike ose 20,09 % nga numri i pergjithshem i filmave, kurse amerikane 102 ose 45 % dhe keto bile ma teper nga rezervat qe jane gjete me rastin e çlirimit te vendit. Ne vitin 1946 ndryshoi proporcjoni: filma sovjetike 127 ose 73,84 %, kurse amerikane gjithashtu 127 ose 33,34 %. Ne vitin e kaluem jane çfaqe 137 filma sovjetike ose 46,58 %, kurse filma amerikane gjithsejt 38 ose 10,41 %.

Per gjashte muejt e pare te ketij viti, filmi amerikan tek na asht hjeke gadi krejtesisht. Prej 1 kallnduerit te vitit 1948, e deri me 1 korrik te vitit 1948 jane çfaqe 180 filma sovjetike, ose 71,2 %, kurse filma amerikane gjithsejt 7 ose 2,6 %.

Edhe keta te 7 filma amerikane qe jane dhane mbas nji zgjedhjeje te hollesishme te filmave ma te mire te produkcjonit amerikane, kalojne keq. „Slovenski Porocevalec" ne numrin e 10 korrikut te ketij vjetit botoi nji lajm me titull „Lublana e largon filmin e keq", ku thuhet se ne Lublane jane pregatite demostrata me rastin e dhanjes se filmit amerikan „Serenata mbi lige", se rinija e qytetaret kane ngrehe çadrat para aparatit projektues ne shej proteste dhe keshtu e kane penque çfaqjen e ketij filmi. „Slovenski Porocevalec" e perfundon ket lajm me keto fjale:

„Me kete demostrate spontane kundra paraqitjes se filmit amerikan „Serenata mbi lige", rinija e Lublanes prap e trego pjekunin e saje te plote".

Keto rezultate jane mbrrijte ne saje te punes se pakpatun te Partis Komuniste n'edukimin ideologjik jo vetem t'antarve te saje, por edhe te shtresave ma te gjona popullore.

Edhe ky asht gjithashtu realiteti jugosllav.

Mjerisht, Hungarija nuk asht i vetmi vend i demokracis popullore ku favorizohet aq fort filmi amerikan. Per te mos u zgjate teper dhe per te mos permende shembuj nga te gjitha vendet e demokracis popullore, po ndalemi vetem ne Çekosllovaki. Prej 9 deri me 15 korrik ne Prage jane çfaqe 31 filma amerikane, 14 filma angleze, 10 filma franceze, 1 film Belgjan, e gjithsejt 18 filma sovjetike e 4 filma Çekosllovake.

Ndersa ne Beograd prej 9 deri me 15 korrik jane çfaqe 24 filma sovjetike, 5 filma Franceze, 1 film Çekosllovake dhe vetem nji film amerikan.

Edhe ky asht realiteti jugosllav.

Si ne shtyp, botime e filma, ashtu edhe ne format e tjera t'agitacjonit dhe te propagandes, Partija Komuniste e Jugosllavis e zbaton besnikisht linjen e saje te popullarizimit te Bashkimit Sovjetik. Nuk po permendim ma shembuj. Qellimi i ketij artikulli nuk asht me e kritikue politiken kulturore te partive tjera, por me tregue me fakte padrejtesin e akuzes se Byros Informative mbi qendrimin t'one ndaj Bashkimit Sovjetik; ky artikull ka per qellim me provue edhe nji here se sa e palodhshme asht puna e Partis Komuniste te Jugosllavis per njohtjen e masave punuese te Vendit t'one me fitoret e Bashkimit Sovjetik.

I keshille asht realiteti jugosllav. Prej kendej rrjedhe gjith kjo kompaktesi ne Partin t'one, prej kendej rrjedhe gjithe ky unanimitet i popullit t'one ne refuzimin e akuzave te padrejta te Byros Informative.

Vladimir Dedijer.

Lajme nga bota

Atentati kundra Toliatit asht sulm mbi mbare klasen puntore t'Italis

Para nji jave asht ba atentati kundra Sekretarit gjeneral te Partis Komuniste t'Italis Palmiro Toliati, ne momentin kur ishte tue dale nga Parlamenti. As shtypi senzacjonal i bulevardeve nuk i ka kushtue kujdes atentatorit. Asht dijtë se rrajet e ketij krimi jane te thella, e krimineli, gja e dores se dyte. Krimi asht ba kundra udheheqsit te klases puntore, e siç kane thane deputetet demokrate ne Parlament, krimi asht drejtue kundra mbare klases puntore. Ky krim asht vetem edhe nji hallke ne zinxhirin e provokimeve dhe te krimeve qe i bajne reakcjoni dhe fashistat kundra udheheqsave te puntorve, qendrave te partive Komuniste, sindikatave dhe demokratve te shquem. Qellimi i ketyne krimeve dhe provokimeve asht me ngacmue klasen puntore dhe me krijue atmosferen e luftes civile dhe ne kete menyre te gjindet justifikimi per premjen e te drejtave te greves, per lanjen jasht ligji te partis Komuniste dhe keshtu te veshtiresohet lufta e fuqive demokratike kundra reakcjonit Vatikanit. Fletoria fashiste «Umanita» ka shkrue haptazi, dy dite para atentatit se „te gjithe komunistat duhet me i mbeshtete per mure". Keshtu kane shkrue edhe fletoret reakcjonare para zgjedhjeve kur frigoheshin nga fitoret e Frontit popullor demokratik, po nji-soj kane shkrue edhe urdhendhansat e tyne ne Newjork. Prandaj, klasa puntore e Italis dhe te gjitha fuqite demokratike te botes e kane dijte se rrajet e ketij atentati dalin s'andejmi, se imperjalistat amerikane i kane dhane armet ne dore atentatorit e se ata i armatosin dhe iu japin guxim agresorve. Per kete arsye deputeti Paoluçi, i cili asht shkeputë nga republikanet, ka shprehe deshiren e te gjithe demokratve kur ka kerkue qe qeverija bandite, fashiste dhe kapitaliste e de Gasperit te jape dorehekjen, sepse atentati kundra Toliatit asht atentat kundra mbare klases puntore. Klasa puntore keshtu e ka kuptue kete atentat, ajo e ka dijte se ky asht vazhdimi i sulmeve edhe ma te paturpshme kundra te drejtave te klases puntore, se ky asht fillimi i provokimeve edhe ma te randa, prandaj ka ba greve gjenerale ne mbare vendin, sa qe kurrfar frigimesh dhe masash policore e ushtarake nuk kane mujte me ndale puntorin nga greva e pergjithshme.

Atentati kundra Toliatit asht shej dobsije i reakcjonit italian. Sulmet kriminale kundra grevistave jane vetem shej se reakcjoni nuk asht ne gjendje me ndryshue dhe me e terhjeke klasen puntore nga rruga e perparimit dhe e liris.

Atentat kundra Sekretarit te pergjitheshem te Partis Komuniste te Japonis-Tokudo-s

TOKIO:

Me 19 te k.m. asht ba atentat kundra Sekretarit te Pergjithshem te Partis Komuniste te Japonis — Tokudo. Atentati asht ba me nji bombe dore, e cila ka eksplodue para kambeve te tij dhe e ka plagosë ne krye, ne dore te majt dhe ne kambe. Atentati asht ba ne lokalin e komunes ne Sagi n'ishullin Kiushiu. Me gjithse ka marre tridhete tete plage te vogla e te mdha, Tokuda e ka perbajte vedin deri ne perfundimin e fjalimit qe ishte tue e mbajte. Atentatori u asht dorzue agjentave te sherbimit informativ amerikan. Gjendja shendetsore e Tokudos asht ne permirsim e siper.

Partija Komuniste e Japonis u ka drejtue nji deklarate te gjithe puntorve, katundarve dhe nepunsave te Japonis, ne te cilen thuhet se ky atentat asht nji akt i poshter terori i elementave militarist te Japonis. Ne fund te deklarates thuhet se i gjith faji randon mbi qeverin reakcjonare t'Ashidinit dhe kerkohet dorehjekja imediate.

MOSKE:

Tassi njofton: Sekretari i KQ te PK (b) te BRSS Georgi Malenkov i dergoi kete telegram KQ te PK te Japonis.

„Komiteti Qendruer i PK (b) te BRSS me indinjate e ka marre vesht atentatin e poshter te sherbetorit te ndyet t'amiqve te popullit japonez kundra shokut Tokudo—udheheqsit te shquem te klases puntore te Japonis. Komiteti Qendruer i PK (b) te BRSS i shprehe KQ te PK te Japonis keqardhjen e vet miqsore dhe shpreson se shoku Tokudo per se shpejti do te kthehet ne veprimtarin e tij te vlefshme per ndertimin e Japonis se re demokratike dhe paqdashese".

ROME:

Agjensija ANSA transmeton lajmin e buletinit mjeksuer mbi gjendjen shendetsore te Palmiro Toliatit dhe thote se gjendja shendetsore e tij po permirsohet vazhdimisht.

Lufta e popullit heroik grek

ATHINE:

Radjostacjoni i Greqis se lire transmeton lajmin e Elefteri Elada mbi operacjonet e Armates Demokratike me 20 korrik, e cila ne mes te tjerash thote se dy batalionet e divizjonit II monarko-fashist kane tentue me e marre nji pozite dominuese ne sektorine Zuzelis. Mirepo, edhe kjo orvatje e anmikut ka deshtue, sepse nji kompani anmike ka ra ne fushen e minueme e tjetra ne zjarmin e rebte te njisive t'Armates Demokratike. Anmiku ka psue humbje te randa. Fuqitë tjera t'anmikut kane qene rekspozueme kundra sulmeve te forta te njisive t'Armates Demokratike dhe jane detyrue me ike. Ne kete lufte anmiku ka lane 18 te vrame dhe 54 te plagosun. Luftime jane zhvillue edhe ne sektoret e tjere dhe njisit e Armates Demokratike e kane shqetsue mjaft anmikun si nder fronte ashtu dhe ne mbrapavija.

BUKURESHT:

Ne Bukuresht asht nenshkrue pakti i Miqesis, ndihmes dhe bashkpunimit reciprok ne mes te Republikes Popullore te Rumanis dhe Republikes te Çekosllovakis. Pakti asht lidhe me nji vlefte prej 20 vjetesh dhe si pike kryesore permban çashtjen e ndihmes reciproke ne rast te ndonji agresjoni te ri gjerman ose çfardo agresjonit tjeter.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Popullor Prishtine ne te
lutur i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.